REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.4045/1 prot. Lushnje 14/05/2025

PROJEKT – VENDIM Nr.42
"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.75 DATË 28.08.2024 DHE MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2025"

Këshillit Bashkiak Lushnje, në mbledhjen e datës ___/___/2025, pasi të marri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori për Planifikim dhe Përballimin e Emergjencave civile, Sektori i MNZSH, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 29 pika 2 të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Neni 45 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH" i ndryshuar. Neni 44, neni 45 të Udhëzimt nr.09 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit". Neni 4, neni 8 shkronja "ç", neni 30 shkronja "f", neni 42 shkronja "b", neni 65 pika 2 të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile". Pika 1 shkronja "ë" të VKM nr.290, datë 17.05.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e proçedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile". Neni 113 të ligjit Nr.44/2015. "Kodi i Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë" Ju:

PROPOZOJMË:

1. Shfuqizimin e Vendimit nr.75 datë 28.08.2024 "Për shfuqizimin e vendimit nr 75 date 29.09.2023 dhe miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2024".

2. Miratimin "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2025 për blerjen e një mjeti zjarrëfikës në shumën 6.000.000 (gjashtëmilionë)lek.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori për Planifikim dhe Përballimin e Emergjencave Civile, Sektori i MNZSH, Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria Jurdike dhe Prokurimeve (Zyra e Prokurimeve).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKTORI PËR PLANIFIKIM DHE PËRBALLIMIN
E EMERGJENCAVE CIVILE

I AUTORIZUAR
Elton Koroveshi

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

SEKTOR I MNZSH
Xhezmi Metushi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
SEKTORI PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr.4001 Prot **Lushnje më 13/05/2025**

Lënda: Kërkesë për blerjen e një mjeti zjarrfikës për nevojat e M.Z.SH.-së Lushnje.

KRYETARES SË BASHKISË

Znj. Eriselda Sefa

Znj. Kryetare!

Ju vëmë në dijeni se Sektori i MZSH-së, Bashkia Lushnje aktualisht disponon në gjendje pune për kryerjen e detyrave të tij në përballimin e situatave të ndryshme emergjente si zjarre, përmbytje, aksidente të ndryshme, etj, automjetet si më poshtë:

1. Zjarrëfikse e vogël Tip Ford kapaciteti 200 l ujë.
2. Zjarrëfikse e mesme Tip Reno kapaciteti 2000 l ujë.

Duke qenë se këto mjete që kemi në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për territorin që ky sektor mbulon dhe për shumëllojshmërine e situatave të ndryshme që lindin në terren gjatë kryerjes së detyrave tona

Mendoj se është emergjente dhe e domosdoshmeblerja e një automjeti tjetër zjarrfikës që do të ndikojë në përmbushjen e detyrave tona për ti ardhur në ndihmë komunitetit në rast nevoje.

Përgjegjësi i Sektorit të MZSH-së Lushnje

Inspektor Xhezmi Metushi

Adresa: Lagja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr 6775/3 prot

Lushnje 29/08/2024

VENDIM

NR. 75 DATË 28/08/2024

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.75 DATË 29.09.2023 DHE MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2024"

Këshillit Bashkiak Lushnje,në mbledhjen e datës 28/08/2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave civile,Sektori i MNZSH,në mbështetje të nenit 9 pika 1.3,nenit 29 pika 2 të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore ".Neni 45 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH" i ndryshuar.Neni 44,neni 45 të Udhëzimit nr.09 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Finacave dhe Ekonomisë 'Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit".Neni 4,neni 8 shkronja"ç",neni 30 shkronja"f",neni 42 shkronja"h",neni 65 pika 2 të ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen civile.Pika 1 shkronja"ë" të VKM nr.290,datë 17.05.2023"Për një ndryshim në VKM nr.414 ,datë 08.07.2021"Për miratimin e proçedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".Neni 113 të ligjit Nr.44/2015,"Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë".

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.75 datë 29.09.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2023"
2. Miratimin "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2024 për blejren e një mjeti zjarrfikës me autoshkallë në shumen 6.000.000(gjashtë miljonë)lek me tvsh.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori për Planifikimin dhe Përballimin e Emërgjencave Civile.Sektori i MNZSH,Drejtoria e Finance-Buxhetit,Drejtoria Juridike dhe Prokurorimeve (Zyra e Prokurorimeve).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com